



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:258107
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05310595

C.nr.4348/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe praktikanten A.K. duke vendosur në çështjen juridiko kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS), në Prishtinë, Departamenti Ligjor Prizren, kundër të paditurit N. (Xh) B. me numër personal me vendbanim në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 93.05€, jashtë seancës gjyqësore, me datën 24.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Lëshohet urdhërpagesa për paditësin Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS), dhe detyrohet i padituri N. (Xh) B. nga Prizreni, që në emër të kompensimit të dëmit, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 93.05€ (nëntëdhjetetë euro e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së kësaj padie me datë 15.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, apo që brenda afatit të njëjtë të parashtrorj prapësimin kundër kësaj urdhërpagese.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS) - Distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit N. (Xh) B. me numër personal me vendbanim në rrugën “Arsim Berisha” p.n në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 93.05€.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren nën shenjen: P.nr.1474/21 i datës 09.08.2022 dhe Faturën me nr. DPZ20HP2117169 të datës 16.09.2021.

Me Aktgjykimin P.nr.1474/21 i datës 09.08.2022, (nr. i lëndës 2021:297053), vendim ky i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 21.09.2022, gjykata ka vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 të Kodit Penal

të Kosovës, dhe me faturën nr. DPZHP2117169 të datës 16.09.2021, konstatohet se i padituri për shkak të rikthimit të humbjeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, paditësit duhet ti paguaj shumën e lartcekur.

Nga se u tha më lartë, e konform dispozitave ligjore të nenit 493.3 dhe 495 lidhur me nenin 497.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:258107, 24.01.2024**

Gj y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLA JURIDIKE: I padituri mund ta godisë urdhërpagesën vetëm me anë të prapësimit dhe atë brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimi të së njëjtës. Prapësimi i paraqitur me vonesë do të hudhet poshtë.